

# Çfarë mund të bëni për të luftuar COVID-19

## TESTIM




Mësoni gjendjen tuaj. Merrni teste falas të COVID-19 dhe të antitropave.

## GJURMIM



Përgjigjuni thirrjes së gjurmuesve tanë të kontakteve për të ndihmuar ndalimin e përhapjes së COVID-19 në komunitetin tuaj.

## PËRKUJDESJE



Veçohuni në mënyrë të sigurt për të mbrojtur të tjetër dhe merrni përkujdesje në hotel apo në shtëpi.

NYC Test & Trace Corps është i përkushtuar në mbrojtjen e privatësisë dhe të sigurisë së informacionit tuaj personal dhe shëndetësor. I gjithë informacioni është konfidencial dhe i mbrojtur sipas Kodit Shëndetësor të Qytetit të Nju-Jorkut. Test & Trace Corps nuk do të pyesë për statusin e imigrimit të askujt.

**NYC**  
**HEALTH+**  
**HOSPITALS**

**Test & Trace**  
**Corps**

# Mbroni veten. Mbroni njerëzit tuaj të dashur. Ndhmoni në rihapjen e qytetit të Nju-Jorkut.

Çdo njujorkez luan një rol të rëndësishëm në rihapjen e sigurt të qytetit tonë dhe në uljen e përhapjes së COVID-19. Ja tre hapa që mund të ndërmerrni me mbështetjen e NYC Test & Trace Corps për të mbrojtur veten, njerëzit tuaj të dashur dhe të gjithë komunitetin tuaj. Ndhmoni në rihapjen e sigurt të qytetit të Nju-Jorkut!

## Testohuni – për ta pasur mendjen të qetë

Mund të testoheni FALAS PËR COVID-19, për të mësuar statusin tuaj dhe për ta pasur mendjen të qetë. Kontrolloni pikat që ofrojnë gjithashtu testim për antitropa për të përcaktuar nëse e keni kaluar më parë virusin. Testet janë FALAS, të sigurt dhe konfidenciale. Nëpër qytet ka qindra pika testimi të NYC Test & Trace Corps.

**Nuk ka nevojë për të lënë takim. Vizitoni [nyc.gov/covidtest](https://nyc.gov/covidtest) ose telefononi 311 për të gjetur një pikë testimi pranë jush.**

## Përgjigjuni thirrjes – për të ndaluar përhapjen

Nëse rezultoni pozitiv në test ose nëse jeni ekspozuar ndaj COVID-19, do të merrni një telefonatë nga një gjurmues kontaktesh i NYC Test & Trace Corps. Përgjigjuni telefonatës nëse shihni NYC Test+Trace ose numër me kodin e zonës 212.

**Gjurmuesit e kontakteve do t'ju:**

- Pyesin si ndiheni.
- Ofrojnë burime për t'ju ndihmuar të qëndroni të shëndetshëm dhe të veçoheni në mënyrë të sigurt nga të tjerët.
- Shpjegojnë se sa kohë ju duhet të qëndroni brenda dhe larg njerëzve të tjerë.

**Nëse rezultoni pozitiv për COVID-19, gjurmuesi i kontakteve gjithashtu do t'ju:**

- Bëjë pyetje për të mësuar se si mund të jeni infektuar.
- Pyesë për emrat dhe informacionin e kontaktit të gjithkujt me të cilin keni pasur kontakt të ngushtë për t'ju ndihmuar t'i mbroni dhe për të parandaluar përhapjen e virusit tek të tjerët.

**Gjurmuesit e kontakteve kurrë nuk do t'ju:**

- Pyesin për emrin tuaj apo numrin e sigurimeve shoqërore.
- Pyesin për informacion financiar privat apo të kartave të kreditit.
- Kërkojnë të përdorni apo shkarkoni programe në celular, tabletë apo kompjuter.

Nëse gjurmuesi i kontakteve nuk lidhet dot me ju përmes telefonit, mund t'u duhet t'ju vizitojnë personalisht për të parë nëse jeni mirë. Ata do t'ju paraqesin identifikimin e tyre për të vërtetuar se janë gjurmues kontaktesh të NYC Test & Trace Corps.

## Përkujdesuni – për të mbrojtur njerëzit tuaj të dashur

Nëse jeni diagnostikuar me COVID-19 apo keni qenë në kontakt me dikë që ka rezultuar pozitiv, NYC Test & Trace Corps mund t'ju ndihmojë të veçoheni në mënyrë të sigurt në një hotel apo shtëpi.

Hotelet e përkujdesjes janë pa pagesë, të sigurt, komode dhe praktike. Ne ofrojmë transport, vakte, internet, televizion kabllor, kondicioner, mbështetje për mirëqenien mendore dhe fizike, si dhe telefonata lokale pa kufizim për të ruajtur kontaktin me njerëzit tuaj të dashur.



Për më shumë informacion, telefononi në nr.  
**1-212-COVID19** (1-212-268-4319)  
ose vizitoni [testandtrace.nyc](https://testandtrace.nyc)

**NYC  
HEALTH+  
HOSPITALS**

**Test & Trace  
Corps**